

## KONTRATË SHITBLERJE

(KUOTASH)

Sot më datë 23/05/2024 mes palëve të mëposhtme kontraktuese lidhet kjo kontratë shitblerje kuotash:

**Shitësi:** **Z. Alban Shanaj**, shtetas shqiptar, atësia Agron, lindur me 19.04.1986, lindur në Tiranë dhe banues në adresën: Rr. "Adem Jashari", Nd. 31, H. 4, Ap. 14, Tirane, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Pasaportën me nr. BI6967458 dhe nr. personal I60419061K.

(referuar me poshtë si **Shitësi**)

**Blerësi:** **Z. Ilir Myftari**, shtetas Shqiptar, atësia Myzalim, lindur më 07.11.1986 në Tiranë dhe banues në adresën: Rr. "Muhamet Gjollësia", Pall. 37, Shk. 4, Apr. 73, Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftimin me nr.036518759 dhe nr. personal I61107040N.

(referuar më poshtë si **Blerësi**)



### Dispozita të përgjithshme

- A. Shoqëria "AI.20" sh.p.k., është person juridik, i regjistruar në Regjistrin Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) me Nr. NUIS M41324029D. Kapitali i shoqërisë "AI.20" sh.p.k., është 10,000 (dhjetë mijë) Lekë, i ndarë në 2 Kuota, ku 1 kuotë e zotëron Alban Shanaj dhe 1 kuotë e zotëron Ilir Myftari.
- B. Shitësi është ortak i shoqërisë "AI.20" sh.p.k., dhe zotëron 1 kuotë, në masën 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, me vlerë 5,000 (pesë mijë) Lekë dhe dëshiron t'ia shesë blerësit të gjithë kuotën e tij, në tërësi.
- C. Blerësi është ortak i shoqërisë "AI.20" sh.p.k., dhe zotëron 1 kuotë, në masën 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, me vlerë 5,000 (pesë mijë) Lekë. Blerësi dëshiron të blejë nga shitësi, kuotën që përbën 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, me vlerën totale prej 5,000 (pesë mijë) Lekë.

Në përputhje me nenin 73: "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave" pika 1/b dhe pika 3 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", neni 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe në Statutin të Shoqërisë "AI.20" sh.p.k, Palët bien dakord sa më poshtë:

### Neni 1 Objekti

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është shitja e 1 (një) kuote, që Shitësi e zotëron në kapitalin themeltar, e cila përfaqëson 50 % (pesëdhjetë përqind) të Kapitalit të Shoqërisë. Kjo kuotë transferohet nga Shitësi në pronësi të Blerësit.



1

- 1.2 Blerësi pranon pronësinë e 1 (një) kuote dhe pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kjo pronësi.

## **Neni 2 Çmimi i Shitjes**

- 2.1 Çmimi për blerjen e kuotës do të jetë në total 5,000 (pesë mijë) Lekë.  
2.2 Blerësi e ka likujduar të gjithë çmimin në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate pranë Shitësit.

## **Neni 3 Garancitë**

- 3.1 Shitësi është pronar i vetëm i ligjshëm i kuotës, që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit në shoqërinë "AI.20" sh.p.k, rrjedhimisht kuota që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind) të  
3.2 kapitalit, që kalon në pronësi të blerësit.  
3.3 Shitësi garanton Blerësin që kuota e transferuar, që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit, është krejtësisht e lirë dhe nuk është vendosur si mjet ligjor për të siguruar ekzekutimin e ndonjë detyrimi.  
3.4 Palet deklarojnë dhe garantojnë se duke lidhur dhe zbatuar këtë Kontrate nuk vijnë në kundërshtim me ndonjë dispozitë ligjore, kontraktuale apo statutore, kur është e zbatueshme.

## **Neni 4 Regjistrimi**

- 4.1 Regjistrimi i transferimit të kuotave në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) kryhet në bazë të nenit 74 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 « Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare » si dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

## **Neni 5 Ligji i zbatueshëm**


- 5.1. Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë", Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", si dhe Statuti i Shoqërisë "AI.20" sh.p.k.

## **Neni 6 Juridiksioni**

- 6.1. Për çdo mosmarrëveshje lindur mes Palëve lidhur me interpretimin, zbatimin e kontratës e cila nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim mes tyre, juridiksioni kompetent do të jetë ai i Gjykatës e Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

## **Neni 7 Dispozita të fundit**

- 7.1 Nenet e përgjithshme janë pjesë e pandarë e kësaj kontrate.




2

- 7.2 Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët.  
7.3 Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me pëlqimin e të dyja palëve, duke respektuar formën shkresore.

Kjo kontratë u përpilua në 2 (dy) kopje me vlerë të barabartë ligjore, në gjuhën shqipe. Palët deklarojnë se njohin dhe kuptojnë të gjithë përmbajtjen e kësaj kontrate. Kontrata u pranua nga palët dhe u gjend sipas vullnetit të tyre të lirë dhe të shprehur. Ajo u nënshkrua në mënyrë të rregullt, nga palët.

**SHITËSI**

Z. ALBAN SHANAJ

Alban shanoj 

**BLERËSI**

Z. ILIR MYFTARI

Ilir Myftari 